



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 60/01-16843/22
Kaçanik, 27.06.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VI (gjashtë) e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 27 qershor 2022. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsyen, Bashkim Luma.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkyryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtori e drejtoreve: Qamil Stagova- DUKMM, Bahri Selimi, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Sali Malsiu-DSHMS, Ramadush Osmani-DSHPE, Suhad Dullovi-DBPZHR, Pranvera Loku-Zharku, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Fatlume Guri-Selimi, Bejtulla Dalloshi, Arbnora Kuka, Bujar Bajra, Çlirim Troni. Nga OJQ, punimet e mbledhjes i përcollë 1 qytetar.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Telprezencës nga Gëzim Sahiti- zyrtarë i lartë për monitorim të komunave në MAPL.

Mbledhjen e kryesoit Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtëse Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VI (gjashtë) të rregullt të kuvendit të komunës për vitin 2022, data 27 qershor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;
2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës për vitin 2023-2025;
3. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;
4. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale 01208-2, Mal i klasës 3 në sipërfaqe 504m² dhe livadh i klasës 3 në sipërfaqe 1722m² në emër të Nexhmedin (Mustafa) Elezi nga f. Sllatinë;
5. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 000729-8 zona kadastrale Bob, në vendin e quajtur “Oborr”, Arë e klasës 6, pronë e Blerim (Ajet) Çaka nga Bobi-Kaçanik;
6. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 350m² në parcelën kadastrale 02302-2 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur “Shoko bare kalishtë” në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, nën qiramarrje 99 vjet;

7. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 001334-13 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur “Perovina”, në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër;
8. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 001334-12 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur “Perovina”, në emër të Burim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër;
9. Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2021;
10. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve në raportin e auditimit të dhënë nga ZKA, për vitin 2021;
11. Plani i Reagimit Emergjent për mbrojtje nga fatkeqësitet natyrore dhe fatkeqësitet tjera në objektin e administratës komunale të komunës së Kaçanikut;
12. Propozim vendim për transfer dhe rialokim te mjeteve sipas buxhetit 2022;
13. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Bob, parcela me nr. 175-0, në emër të Bekim (Emrush) Dema - harmonizimi i vendimit sipas kërkesës së MAPL;
14. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Begracë, 17 parcela të evidentuara në emër të N.P.P.T.T.SH. ALK-OIL me nr. të biznesit 70052105 dhe Drilon Shamollit - harmonizimi i vendimit sipas kërkesës së MAPL.
15. Kërkesa e MBPZH për Anulimin e Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 01402-1 ZK Soponicë, me kulturë Bujqësore Arë e Klasës së 5, me sipërfaqen 3917m², pronë e Ekrem (Ramadan) Hyseni nga Ferizaj, nën qiramarje 99 vjet;
16. Kërkesa e MBPZHR për Anulimin e Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 01123-6 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI;
17. Kërkesa e MBPZHR për Anulimin e Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 00311-0 zona kadastrale Ivajë, me kulturë bujqësore Livadh i klasës së 6, pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku.

Lidhur me Rendin e propozuar të punës e hapi diskutim, por nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVON

Rendin e punës në përbërje prej 17 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj:

z. Adnan Reka: Në f. 5 të diskutimi im, të programi i banimit social është lëshuar një gabim teknik ku shënohet shuma 16.000€, duhet të jetë shuma: 600.000€.

Kryesuesi i Kuvendit: Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK me vërejtjen e Adnanit e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVON

Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës e datës 31.05.2022 / Lënda: 01Nr. 01Nr. 60/01-13696/22. Procesverbalia publikohet i korriguar në faqen zyrtare.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave;

Pyetje dhe Kërkesa

z. Ardit Rrahmani: Nuk po e shoh të arsyeshme me ngritur ndonjë pyetje apo kërkesë, për shkak së përgjigje po i marrim në ditën e fundit, apo nuk po i marrim fare. E kuptoj ekzekutivin për ngarkesat që i kanë, por është në obligim të tyre edhe njerëzore dhe morale me na kthyer përgjigje, se tek e fundit kërkesat dhe pyetjet janë të qytetarëve. Adresa e shqetësimeve jemi ne, zgjidhja dhe përgjigjet duhet t'i marrim nga ekzekutivi. Faleminderit drejtorit të DSHPE që na i ka sjellë sot përgjigjen, ka qenë me e arsyeshme me i marrë me herët, janë edhe 2 pyetje që i kam ngritur me herët që nuk kam marrë përgjigje, besoj se e njëjta vlen edhe për anëtarët tjere të opozitës së ata të pozitës nuk është se kanë pasur ndonjë kërkesë apo pyetje.

z. Adnan Reka: A mund të na thoni përsë video incizimet e seancave të kuvendit ka kohë që nuk po shfaqen me kohë në youtube ne faqen e komunës. Shfrytëzoj rastin që përmes këtij kuvendi t'i bëjë thirrje edhe zyrtarëve të ministrisë që janë përgjegjës për monitorimin e seancave të kuvendit që ta kenë parasysh një gjë të tillë, sepse shfaqja e incizimeve pas 1 apo 2 javësh vërtetë e humbë kuptimin.

Kryesuesi i Kuvendit: Keni të drejtë Adnan, besoj që se është çështje teknike, e di së janë në proces të prokurimit, besoj se kjo çështje rregullohet sa më shpejt që është e mundur.

z. Naim Beça: 1. Kam një kërkesë që komuna me bërë investime në krijimin e kushteve të punës në Bibliotekën e Kaçanikut. Gjatë sezonit të dimrit me pasur ngrohje, ndërkaq verës, klimë.

2. Pyetjen që e kam ngritur për prishjen e kubzave, përgjigja me ka ardhur kështu: "Këtë javë do të fillojmë me sanimin e gropave me shtresë asfalti". Unë nuk kam thënë me u shtruar me asfalt, unë kam thënë se kubzat janë prishur-janë zgjeruar, duhet marrë veprime me sanuar gjendjen.

z. Arlinda Rakoci-Raka: Kur do të bëhet fasadimi i objektit të ndërtesës prapa shtëpisë së kulturës "Xheladin Kurtaj", kur e dimë se buxheti është ndarë për këtë projekt.

z. Kadrije Lika-Troni:

1. Një përgjigje që kam marrë nga drejtoria e Bujqësisë lidhur me ndarje e mjeteve të punës për fermerë, unë e kam ditur se 2 nënshkrime nëse mirën kalon vendimi, unë kam dashur me ditur cila është arsyja që nuk ka nënshkuar një anëtar i komisionit. Lidhur me këtë çështje unë mundem me kërkuar edhe qasje në dokumente publike.

2. A ekziston rregullorja për hapjen e kutive të ankesave, dhe a ka afat ajo, se me duket se i ka dalë afati gjatë vitit 2022.

z. Agim Çaka:

1. Organizmi i mbledhjes solemne në objektin e "Kulla e Hasanit" ishte shumë i mirë, Me intereson statusi i këtij objekti -objekt ky me interes publik në pronë private dhe çështja e asfaltimit të rrugës, se kishte me pasur qasje me të mirë edhe për nxënës dhe turistë që donë me vizituar.

2. Në shumicën e komunave kanë marrë veprime përvendosjen e tri shkronjave të UÇK në një pjesë të përshtatshme. Kjo është mirë të aplikohet edhe të ne, ndërkaq si ide fillestare kishte me qenë mirë me u vendosur në pjesën e Gurit të Shpum. Nuk e di si i kanë bërë vendet tjera, me iniciativa private apo grupore, mendoj se vendimi duhet të merret në KK.

3. Si është çështja e statusit të Senatoriumit. A ka ndonjë problem, nëse po, a mundet me u zgjidhur problemi dhe ajo pronë me u shfrytëzuar përvinteres të komunës?

4. Çështja e dukurive që po bëhen publike lidhur me armët e ftohta që po përdorën në shkolla, kam dëgjuar fjalë që një pjesë e armëve të tilla është gjetur edhe në shkolla tona. Fillimi i vitit të ri shkollor duhet me u bërë përgatitje të mira, ashtu që dukuritë ne tillë mos të shfaqen në shkollat tona. Përgjegjësia përvdukuri të tillë bie tek; prindërit, arsimtarët, drejtoria e deri të policia.

5. Çështja e ujit të pijes; A keni njohuri se a kanë probleme me ujin e pijes, Dubrava, Doganaj, se çështja e ujit është jetike përvqytetarë?

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje dhe Kërkesa tjera nuk kemi, kalojmë në pikën vijuese:

2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës përvitin 2023-2025;

Fillimisht ia kaloj fjalën drejtorit të DBF, Bahri Selimi, pastaj e hapi diskutimin:

z. Bahri Selimi: Pasi te pranohet Qarkorja e parë buxhetore, komunat nga fillojnë me përgatitur planifikimin e buxhetit përvitin e ardhshëm. Dokumenti që i paraprinë buxhetit është KBAK. Ky dokument iu ka nënshtuar dëgjimit publik dhe është proceduar përvitin. Ka pasur edhe diskutime të brendshme nga ekzekutivi, të gjitha kërkuesat e paraqitura nga qytetarët në zyrën e kryetarit dhe drejtorët e drejtive janë futur në draftin kornizë. Ky dokument dallon nga buxheti, së është me i gjerë se buxheti, 2023-2025, me më tepër vlerësimë, apo një vizion i komunës së nga do t'i ketë orientimet përvitit përvitin. Komuna e Kaçanikut mbetet në fokusim të arritjes së një niveli të lartë të zhvillimit ekonomik në; industri, bujqësi, turizëm, në mëdusë të qëndrueshëm, komunitet të përgjegjshëm arsimim, rini aktive në kulturë dhe sport dhe në kushte të lira përvjetore. Indikatorët e parë të buxhetit janë: 10.674.000€, që është përhershë te parë kjo ngitje. GP kemi në ngritje përvjetore 1.1 milion, GA shënon rënien përvjetore shkak të uljes të numrit të nxënësve, GSH nuk ka lëvizë, përpos një shumë përvjetore politika të reja, IK kanë shënuar ngritje përvjetore 1.3 milion, të HVK përvjetore 173.000€ me më tepër. Buxheti në total shënon ngritje 16%. Në disa projeksione nuk kemi bërë DP me qytetarë sepse ekzekutivi i kalkulon disa kosto siç janë: Pagat dhe mëditjet, shpenzimet komunale, mallrat dhe shërbimet, Subvencionet dhe transferet, Investimet kapitale kanë me qenë temë e diskutimit në DP të ardhshme. IK marrin pjesë me 27% në buxhet.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin e KBAK:

z. Agim Mani: Sa i përket KBAK 2023-2025, duhet të jetë një bazë e caktuar e sektorëve me prioritet përvjetor zhvillimin e komunës, implikimit të prioritetave, shpërndarjes së buxhetit. Si bazë e rëndësishme orientuese është PZHK. Komuna jonë nuk e ka këtë plan, hartat zonale dhe PZH. Pa këtë plan komuna nuk mund t'i realizoj objektivat dhe vizionet e saj. Nëse vazhdojmë me deklaratën e komunës lidhur me prioritetet strategjike, ku thuhet se komuna ka

mjaft pre dispozita atraktive me destinim për zhvillimin ekonomik, kryesore është pozita gjeografike. Kemi autostradë, hekurudhën që lidhë Kosovën me shtetet fqinjë, kemi industri të drurit, burime të shumët ujore, pozitë të përshtatshëm për turizëm, rekreacion, bujqësi, blegtori, industri për zhvillimin e bizneseve të shumët, për këtë pajtohem të gjithë. Kemi potencial njerëzor, por nuk kemi përkushtim të pushtetit për shfrytëzimin e këtyre resurseve me dinjitet për nevoja të qytetarëve. P.sh. kemi burime të shumët të ujit, ndërsa qytetarët nuk kanë ujë, kemi autostradë, hekurudhë, nuk kemi industri, kemi potencial njerëzor, nuk kemi ekonomi as industri. S'ka sport as kulturë, mund të themi se sporti dhe kultura kanë qenë me mirë para 30 viteve sesa tani. Kemi pozitë të mirë bujqësore, blegtori, nuk kemi as blegtori e as bujqësi të zhvilluar. Në këtë draft kornizë keni paraparë ruajtjen e sipërfaqeve bujqësore, kurse në anën tjetër në çdo mbledhje bëhet ndërrimi i destinimit të tyre në tokë ndërtimore. Sa i përket buxhetit të komunës 2023-2025 dhe burimeve financiare, shihet se në vazhdimësi nga GQ ka ngritje të buxhetit, nevojat e qytetarëve janë të shumët, ku duhet të përcaktohen prioritetet, ndoshta prioritet mbi prioritetet nuk e pashtë asnjë në procesverbal takimin me qytetarët për orientimin e buxhetit, kur e dimë që buxheti është për qytetarët. Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesët urbane dhe rurale, janë ndarë 400.000 € për vitin 2023, kurse në vitet tjera 2024-2025 ka një ngritje enorme, 2024, 921.500€, në vitin 2025, 1.287.50€, rritia duhet të jetë konstante. Rruja "Idriz Seferi" vetëm është koduar në vitin 2023, nuk janë ndarë mjete. Zhvillimi i turizmit thuhet se është komponentë kryesore me këtë kornizë, por nuk janë ndarë mjete buxhetore. 50.000 € janë në vitin 2023, ndërkaq në 2 vitet tjera nga 100.000€. Rruja Bob –Doganaj janë ndarë nga 150.000€ në vitin 2024 dhe 2025, d. m. th, është një projekt i ndërtuar me herët, por për shkak të keq-menaxhimi të projektit, rruja është dëmtuar dhe duhet intervenuar përsëri.

Kryesuesi i Kuvendit: Debati publik është organizuar me qytetarë, raporti do t' publikohet në faqen zyrtare dhe do të jetë i qasshëm për të gjithë.

znj. Arditia Rahmani: Në KPF është ngritur një shqetësim për mospjesëmarrje në debate publike, përfshirë edhe mua, kolegët tonë të KK, ndërkaq në anën tjetër bëhet zhurmë për këtë çështje. Ne jemi të obliguar me marrë pjesë në DP. Në KPF është ngritur edhe çështja e rrugës "Idriz Seferi". Pas një debati mes kryetarit dhe anëtarëve të KPF, nuk është arritur ndonjë konkluzion. Kryetari e arsyetoj mos përfundimin e atij projekti për mos koordinimin e nivelit qendor me atë lokal, kjo është për keqardhje pavarësisht kush është në qeverisje. Ne emër të GP i LDK edhe njëherë kërkoj me iu bashkëngjitur kërkësës së kryetarit të gjitha subjektet politike për një takim me zëvendësministri Durmishi, për këtë rrugë- rrugë kjo 100m në vijë ajrore nga komuna. Përpos asfaltit, kësaj rruge i mungon ndriçimi publik. Kjo rrugë është bukur e banueshme dhe është mjerim në gjendje që është, ndërkaq arsyetimet mund të jenë të ndryshme. Kërkoj nga LVV dhe të gjitha subjektet tjera politike të bëhem bashkë rrëth kësaj kërkese. Nëse nuk gaboj, nevojiten 200.000€ për këtë rrugë, është për t'u përshëndetur rrija e buxhetit dhe nuk ka asnjë arsyetim që komuna mos me marrë përsipër këtë projekt. Ne fajin mundemi me hedhur shumë drejtime, por pasojat i vuajnë qytetarët.

z. Rrustem Zenuni: Po ndërlidhem me diskutimin e koleges: Në vitin e kaluar rruja "Idriz Seferi" nga shuma e ndarë nga qeveria paraprake 176.000 €, ndërkaq tani qeveria e ka zbritur shumën e këtij projekti në 50.000 €. Unë e shoh me ngjyrime politike këtë zbritje të shumës për këtë projekt. Është mirë me ngritur ankesa, por është mirë me i parë nga po vijnë ato, shpresoj të bashkohemi rrëth deklaratës së koleges.

z. Adanan Reka: Në lidhje me dëgjimet publike, unë them se ne asamblistët si përfaqësues të qytetarëve e kemi vendin këtu në kuvend –vend ku ku qytetarët me votën e tyre na kanë dërguar, ndërsa në dëgjime publike vendin e kanë qytetarët dhe ekspertet e çështjeve te

ndryshme, sepse qytetarët nuk kanë zë në kuvend, zëri i tyre jemi ne. Ata e kanë mundësinë e debateve në dëgjime publike, prandaj unë konsideroj se ata së bashku me ekspertë duhet ti shterin debatet ne dëgjime publike, ndërsa ne duhet ti shterim debatet ne kuvend për çfarëdo çështje që lidhet me interesin publik. Sa i përket rrugës “Idriz Seferi, unë do të mundohem në mënyrë kronologjike të sqaroj problemin. Punimet në rrugën “Idriz Seferi” kishin filluar në vitin 2016, kur ministër ishte z. Zharku, i cili atë kohë kishte ndarë një shumë prej 245.000€, dhe punimet kishin vazhduar deri në shpenzimin e kësaj shume. Duhet theksuar se edhe zgjedhjet lokale ishin në vitin 2017. Më pas, erdhi qeveria Haradinaj me z. Lekaj- ministër të Infrastrukturës, në vitin 2018, ministri i kishte pezulluar punimet në këtë rrugë. Në shkurt - mars 2020 (50 ditë) vjen qeveria Kurti I, me ministrin z. Abdixhiku, asgjë nuk bëhet për këtë rrugë. Në qershor 2020, vjen qeveria Hoti me ministrin z. Abrashi. Më 21 dhjetor 2020, Gjykata Kushtetuese merr vendim se zgjedhja e Qeverisë Hoti ishte kundër-kushtetuese. Më 19 mars 2021, 3 ditë para se ta liroj zyrën, ministri Abrashi nënshkruan një memorandum mirëkuptimi me Kryetarin Ilazi në vlerë prej 176.975 € për “vazhdimin e punimeve” në këtë rrugë. Kjo ishte një tallje me ne. Pas 3 ditësh, më 22 mars 2021, vjen qeveria Kurti II, me ministër z. Aliu. Pas disa ditësh zëvendësministri z. Durmishi deklaron se të gjitha marrëveshjet apo memorandumet e nënshkruara pas 21 dhjetorit 2020 nga ministri Abrashi hidhen poshtë, për shkak të jo legjimititetit të asaj qeverie. Në vend se pushteti komunal ta përfundoj rrugën e lënë në një gjendje të mjerueshme, ju u morët me dez-informimin e qytetarëve kinse Qeveria Kurti, me ta marr detyrën e kishte hedhur poshtë këtë projekt.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimet e jashtëligjshme janë organet që i shpallin. Nëse ato organë që i kanë shpallë të jashtëligjshme ato vendime që i potencove, në rregull, por një ministër i ka shpallë sipas tekeve të tij. As ministri as kryeministri nuk munden me përcaktuar një vendim të jashtëligjshëm, është një organ tjetër që i shpallë vendimet e jashtëligjshme. Fjalën e ka Kryetari i komunës:

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Adnani i ceku dy çështje: 1. Debatin publik (DP) me qytetarët dhe 2. Projekti që ka mbetur pezull, normal e ndiej një pjesë të fajit. Të DP nuk është keq me marrë pjesë, se i përfaqësoni qytetarët, si do që të jetë ka qenë vendim i juaj dhe e kam respektuar. Të pjesa e dytë e projektit, nuk është bash ashtu si po thoni ju, këtë e arsyetoj me argumente: Unë kam qenë falënderues për disa projekte të ofruara kur ka qenë ministër L. Zharku, të cilat projekte i kanë munguar komunës tonë, jam falënderues për punën që e ka bërë edhe pse ka pasur mundësi edhe me tepër. Të gjitha ato projekte kanë përfunduar mirë, me defekte apo pa defekte. Të rruga N2, kam thënë, nuk e kam akuzuar vetëm këtë qeveri, e kam akuzuar edhe ministrin Pal Lekaj, kjo ka qenë fuqia ime. Ju e dini, një projekt që ka filluar në gusht 2016 është ndërprerë kontrata se menaxheri ka qenë i qeverisë edhe financimi, Janë arsyetuar se e kanë ndërprerë kontratën një kompanie të papërgjegjshme. Kur ndërpritet një kontratë njëanshëm, na pengon në procedura se kompania ka të drejtën e ankesës deri me zgjedhjen e kompanisë tjetër. Ky projekt nuk është anuluar asnjëherë, mjetet sa herë kanë dalë, por nuk janë udhëhequr procedurat. Kam qenë kritikues i madh, siç kam qenë për ministrin i cili ka qenë 3-4 herë në Kaçanik dhe unë jam njoftuar përmes mediave, se ka pasur obligim moral me më njoftuar. Me ardhjen ne pushtet të ministrit Abrashi, është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit për këtë projekt, ndërkaq e anuloj qeveria e re. Nuk e kundërshtova as atëherë. Kam pasur 2 takime me ministrin Aliu, 2 takime me Zv. ministrin Durmishin, pasi ministri ia kishte bartur disa kompetanca, na pati pritur shumë mirë, me pati premtuar se do t'vijë edhe në Kaçanik se ishte çështja e prerjes se pyjeve atëherë në agjendë, megjithatë e ka pasur agjendën e ngarkuar, nuk ka problem. Dy herë kam qenë të ministri në vitin e kaluar, këtë vit 1 herë, i kam thënë se janë në buxhet 176.000€. Me tha se kemi marrë vendim me i anuluar të gjitha memorandumet, në rregull edhe pse nuk me pëlqeu. Me tha se kemi obligime me të mëdha, ky projekt do të jetë në agjendë në vitin e ardhëm. U pajtova. Në

këtë vit janë futur shumë projekte të komunave tjera, por të komunës tonë për këtë projekt na e zbriti edhe shumën. Kam shkuar për takim me drejtorin Ramadush Osmanin, kam pritur 28 min., me ka premtuar që në javën e parë të muaqit prill do të nënshkruaj memorandumin e bashkëpunimit me komunat, një ndër ta do të jetë ky projekt. Ai kërkoj që procedurat me udhëhequr ne, ndërkaq unë kerkova t'i udhëheq ministria se ashtu është vepruar edhe me herët dhe për shkak të paragjykimeve. Sivjet me tha i keni 50.000 €, 150.000€ në vitin vijues, ndërkaq nuk i tregova se i kemi 100.000€ për këtë projekt. Kam pritur me më thirrur, nuk ka ndodhur, i kemi bërë 3-4 herë telefonata përmes zyrtarëve tonë, na kanë thënë se shumë shpejt do t'iu thirrëm. Jemi duke hyrë në muajin korrik, nuk kemi asgjë në këtë drejtim. Nga 2015-2016 janë koduar mjetet, qysh me koduar pjesën tjetër, kur e kam ditur se mjetet janë koduar dhe me kursyer pjesën tjetër, pasi që projektin po na e realizon ministria. E njëjta gjë është edhe tani, 100.000€ janë, por çështja është me na thënë ata të ministrisë se nuk kemi buxhet me tepër, a keni mundësi ju me ndarë mjetet për këtë projekt. Kemi mbetur peng për mos takim, pa ditur arsyet. Një procedurë pa ankesë është 45 ditë, me ankesë shkon 2-3 muaj. Nëse tani nënshkruhet marrëveshja, punimet fillojnë diku në shtator. Me duket e pa arsyeshme një zvarritje e tillë. Jam në gjendje me juve me ardhur edhe si qytetar i komunës, të diskutojmë këtë çështje për një zgjidhje. Ardita e mori obligim, nuk patëm përgjigje nga subjektet tjerë, sigurisht kanë nevojë me u konsultuar, kjo është gjendja e kësaj rruge deri sot.

z. Adnan Reka: Faleminderit për sqarimet, pajtohem në disa pjesë, në disa jo të sqarimeve. Në muajin e 12 të vitit 2020 qeveria Hoti është shpallë jo legitime nga Gjykata Kushtetuese, ndërkaq ministri Abrashi e ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit vetëm 3 ditë para se me lëshuar zyrën. E dyta, kur qeveria Kurti II i ka hedhur poshtë të gjitha memorandumet që janë marrë pas kësaj date, ka pasur shumë akuza në publik, ato fjalë kanë rrjedhë nga këtu, kështu që në vend se me hapur dyer të komunikimit, mbyllen me na mbështetë ministria. Është dashur me treguar fajin, faji ka qenë të ministri Abrashi që i ka nënshkruar memorandumet e mirëkuptimit e jo të ministri Aliu i cili të gjitha marrëveshjet e nënshkruara pas asaj date i ka shpallur jo legitime. Prandaj, unë mendoj që këtu ka qenë fajti dhe nuk po e mohoj se nuk duhet me u përmirësuar. Ne nuk duhet me mbetur peng i askujt, nëse janë në dispozicion 100.000€ nga buxheti i komunës dhe 50.000€ nga qeveria, rruga ka mundur me u kryer.

z. Naim Beça: Historikisht Kaçaniku është komuna me e shkelur në tërë Kosovën, pavarësisht se cila qeveri ka qenë në pushtet. Kjo është marrë për një pushtet, rruga në zonën e parë është e pashtuar. Qytetarëve iu intereson me u shtruar rruga, ndërkaq përgjegjëse është kjo komunë. Kryetar, ndoshta i ke arsyet e tua, por kryesorja ne jemi të shkelur këtu nga të gjitha pushtetet që kanë ardhur në qeveri. Arsyet mund të janë të shumët, rruga është e pashtuar. Duhet me tentuar jo vetëm anëtarët e KK, Kryetari i komunës por edhe qytetarët me ngritur zërin me u ndarë me tepër mjetet e me u shtruar kjo rrugë, se qytetarët po paguajnë taksa. Mua nuk me intereson kush është kryetar apo ministër, mua me intereson me u shtruar rruga, se në shekullin e 21 rruga në zonën e I-r mos me qenë e shtruar, nuk besoj se ka në asnjë shtet të Evropës apo në ndonjë vend tjetër në Kosovë.

znj. Ardita Rrahmani: Me duket se po i përzicjmë kompetencat nganjëherë nga ajo që na takon. Ne mundemi me ngritur çështje për diskutim sa mundemi me kontribuar si anëtar i KK. Unë desha me u ndërlidhë me z. Reka lidhur me diskutimin të cilin e patëm, të cilin e tërheqë. E ndjeva si obligim se në atë kohë kur është bërë ky memorandum, si juriste desha me treguar se nuk ka ministër që mundet me verifikuar se a është legitim apo jo një vendim, është një organ krejt tjetër i cili e vërteton. E drejta e një ministri është me marrë vendime deri në ditën që e lëshon zyrën. Unë nuk e di nëse ndonjë ministër apo gjykata e ka kthyer ndonjë vendim që është marrë para se me u ndërruar qeveria. Ministri në atë kohë Abdixhiku që ka qenë vetëm 50 ditë në qeveri, po dua me tërhequr paralele, që po thoni se nuk mundeni me pritur mrekulli

për 2 vjet nga qeveria. Akuzat mundem me gjuajmë kah duam, mundemi me i mbrojtur secili subjektet tona politike, por sa është e drejtë si anëtarë të KK, nuk ne di. E ritheksoj me dëgjuar secilin asamblistë kërkuesat e LDK që t'i bashkoheni kërkuesë tonë për një takim me zëvendësministrin për çështjen e rrugës "Idriz Seferi" sepse koha është ofruar deri me miratimin e buxhetit. Shpresoj t 'na bashkëngjiten subjektet opozitë dhe pozita.

z. Adnan Reka: Meqë me u përmend emri dhe subjekti politik, vendimin për shpalljen legjitime të qeverisë e ka marrë gjykata kushtetuese jo ne. E dyta, neve duhet me na bërë thirrje këtu jemi të zgjidhur, se me 100.000 € mund të kryhet projekti, ndërkaj nuk e mohova se nuk do të kontribuojmë. Edhe ne jemi për me kontribuar, por se pari duhet ditur ku me adresuar problemin, problemi është komunal, pastaj nëse kemi mundësi do të kontribuojmë edhe atje.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne e kuptuam drejt kërkuesën e Arditës, ndërkaj duke akuzuar njëri tjetrin nuk mundemi me bërë zgjidhje. Ne duhet gjetur format që rruga me u rregulluar, sepse realizimi i këtij projekti është nevojë e qytetarëve.

Kryetari i Komunës: Në KPF e kam potencuar se janë 2 kode për këtë projekt. Ne këtë çështje po kërkojmë me zgjidhur, me na thënë që vazhdoni ju, të vazhdojmë e mos të thotë ministri së na injoruan, të bëhet kjo me marrëveshje se janë kodet nga viti 2015, të bëjmë zgjidhje, se mjetet janë për këtë projekt.

z. Agim Çaka: Problemi ekziston i rrugës, rruga nuk është e shtruar që sa vite, faji është i të gjithëve. Kush ka mundësi me ndihmuar për komunën tonë, mundësitë janë. Unë kur kam qenë në qeveri kam shfrytëzuar mundësitë e mia me ndihmuar komunën e Kaçanikut. Secili që ka mundësi, është mirë me ndikuar me ndihmuar në këtë drejtim. Ne duhet me shfrytëzuar të gjitha autoritetet, kontaktet shoqërore e miqësore për realizimin e projekteve të komunës tonë. Të KBAK, po ndërlidhem me diskutimin e Agimit, ne nuk mundemi me bërë planifikim buxhetor pa pasur PZHK, Hartat zonale, PZHU, se pasojat e tyre po i shohim edhe tani. Ne mundemi me pasur ide për ndonjë projekt, por çështja është se pa PZHK nuk mund të realizohet asgjë. Në KBAK ne mundemi me diskutuar për; grantet, donacionet, IK, të HVK, ku me i orientuar në projektet që janë me interes të qytetarëve. Për çështjen e debateve publike (DP) të organizuara, debatet janë mbajtur, ndërkaj ankesat vijnë pikërisht nga ata të cilët nuk kanë marrë pjesë. Për me qenë sa më efikas në planifikim dhe zhvillim te projekteve, duhet gjetur forma tjera për çështjen e debateve tjera publike, se po shihet mos interesim i qytetarëve për me marrë pjesë.

z. Naim Beça: A u takua kryetari i komunës me kryeministrin kur i ftoj në një takim kryetarët e komunave?

Kryetari i Komunës: Në atë takim të ftuar me kryeministrin, ka marrë pjesë nënkyetari i komunës, Sabedin Vishi.

z. Naim Beça: Kryeministri i ka ftuar kryetarët e komunave e jo nënkyetarët.

Kryetari i Komunës: z. Naim, në atë takim kanë marrë pjesë edhe nënkyetarët e komunave tjera e jo vetëm nënkyetari i komunës tonë.

z. Naim Beça: Të çështja e debateve publike, unë mendoj se ne duhet me shkuar të qytetarët, edhe ju kryetar me shkuar pak me shpesh, e jo qytetarët me ardhur këtu, për atë qytetaret nuk vijnë. Ne duhet me shkuar sa me tepër të qytetarët, sesa me i ftuar këtu e me iu mbajtur ligjërata se çka është punuar. Mendoj se duhet gjetur forma tjera të takimeve me qytetarë.

Kryetari i Komunës: Çështja e debateve publike(DP) është problem gati çdo kund. Të ne, çështja është se administratorët vijë në zyrën time kur të duan, kërkuesat vijnë përmes tyre, kjo është arsyja që nuk vijnë qytetarët, sepse shqetësimet e tyre i ngritin përmes administratorëve. E dyta, këtë vit është filluar me vonë me projekte, unë i vizitoj 5-6 herë projekte dhe jemi bashkë me qytetarët për shqetësimet e tyre, megjithatë DP janë obligim ligjor me UA me i

mbajtur dhe ne e respektojmë UA për organizimin e tyre, ndërkaq është e drejtë e tyre a vijnë apo jo me i shprehur brengat dhe shqetësimet. Ndonjë formë tjetër ne nuk kemi gjetur me i obliguar qytetarët me marrë pjesë në DP. Diku 90% të qytetarëve i pranojnë në zyrë, të gjitha komunat veprojmë njëjtë.

z. Brahim Imishti: Unë do të ndërlidhëm me diskutimin e z. Agim Mani, që bëri krasime të periudhës së sotme me atë të para 30 viteve, në aspektin kulturor e sportiv. Kërkoj nga z. Mani të me jep një shembull konkret, pse ka qenë atëherë me mirë sesa në periudhën e tanishme, kur dihet fakti se në atë periudhë as procesi mësimor nuk ka qenë në formë të rregullt.

z. Agim Mani: Ku ka qenë KF në vitet e 90 -ta, në cilën ligë, e ku është tanë? Ku janë sot SHKA që kanë funksionuar në atë kohë? Ti je i ri e ndoshta nuk e din sesi ka funksionuar sporti në atë kohë, e unë e di se e kam përfjetuar atë kohë. Si komunë sot nuk kemi asnje ligë të futbollit.

z. Brahim Imishti: Unë jam i ri, por jam sportist edhe vet, atëherë nuk ke pasur mundësi me shikuar sport as në Stagovë e as të Lepenci këtu.

Kryesuesi i kuvendit: Mos të bëjmë krasime kohore se mund të gabojmë. Mënyra e buxhetit, mënyra e funksionimit të klubeve sportive është sipas ligjeve në fuqi që lejon shuma të caktuar të subvencioneve.

z. Ardit Rrahmani: Debat i përkthyer përkthyer po shihet së devijoj krejt. Kërkoj të shtrojmë në votim këtë pikë?

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë KBAK e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 14 votë Për, 7 votë Kundër, Abstenime 5. Pjesëmarrës në votim 26. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025. Drafti KBAK lëshohet në procedurën e debatit publik me qytetarë / Lënda: 01Nr. 400/01-16882/22.

3. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;

Kryesuesi i Kuvendit: Sqaroj për përbërjen e komisionit; 4 anëtarë nga KK, 1 nga ekzekutivi, një nga OQJ dhe një nga fshatrat apo lagjja ku bëhet zgjedhja. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë shkojmë me propozime konkrete:

z. Fitore Vishi: Nga PDK e propozojmë, Fatmir Bunjaku.

z. Agim Mani: Nga LVV e propozojmë, Naim Beça.

z. Ardit Rrahmani: Nga LDK ne propozojmë, Besnik Salihu.

z. Rabije Sallahu: Nga AAK e propozojmë, Ekrem Livoreka.

Kryetari i Komunës: Nga Ekzekutivi: Dardana Tafili-Dauti,

z. Dardana Tafili-Dauti: Nga OJQ, Ardiana Tusha.

Kryesuesi i Kuvendit: Një vend mbetet përfaqësues ku zgjidhen këshillit lokal.

Atëherë, propozimet që dolën i shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtit u aprovua me njëzëri. Pjesëmarrës në votim 26. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i komunës mori:

VENDIM

Për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, në përbërje:

1. **Fatmir Bunjaku-PDK,**
2. **Naim Beça- LVV,**
3. **Besnik Salihu-LDK,**
4. **Ekrem Livoreka-AAK,**
5. **Dardana Tafili-Dauti- Ekzekutivi,**
6. **Ardiana Tusha- OJQ/shoqëria civile,**

**7. Përfaqësues nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal/ Lënda: 01Nr.
104/02-16421/22.**

4. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale 01208-2, Mal i klasës 3 në sipërfaqe 504m² dhe livadh i klasës 3 në sipërfaqe 1722m² në emër të Nexhmedin (Mustafa) Elezi nga f. Sllatinë;

Kryesuesi i Kuvendit: Kryetari i Komunës për 3 pikë për shkak të konflikt interesi, kështu që nuk do të jetë në sallë, se kështu e kërkojnë rregullat. E hapi diskutimin e kësaj pike:

z. Betim Shala: Unë mendoj se më mirë kishte qenë fillimisht të ishin pikat: 16,17 dhe 18 se ndërlidhen me këto pikë, të cilat ministria i ka kthyer të kundërligjshme, ndërsa nuk pajtohem me mënyrën se qysh i ka kthyer ministria këto vendime të kundërligjshme. Unë jam me votuar kundër shfuqizimit të këtyre vendimeve.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne kemi ardhur në një pozitë, ashtu që ministria disa vendime po na i kthejnë e disa po i kalojnë, ne të njëjtat lokalitete, me të njëjtat procedura. Ne vazhdojmë kështu, se nuk e dimë cilat na i kthejnë cilat jo. Ato që kthehen është obligim ligjor me i shfuqizuar. Këtu është fjala për një pronë rrëth lumi lepenc, në atë pjesë tanë është kah zhvillohet turizmi. Tani ka lind nevoja me u ndërtuar objekte aty, ekziston kërkesa e palës, e shqyrtojmë, pastaj e dërgojmë në shqyrtim të ligjshmërisë vendimin.

z. Agim Mani: Lëndët e ndërrimit të destinimit të tokave bujqësore zakonisht po kanë gabime teknike. E kuptoj se drejtori ka ngarkesë, por duhet me kërkuar staf shtesë me i ndihmuar në formën profesionale. Në protokoll të lëndës është 17.06 të gjitha kërkesat, tjetër, iu referoheni ligjit 02/L-26 për tokat bujqësore neni 6 pika 6.3. Pala ka kërkuar ndërrim destinimi 1000m², komision nuk ka dal fare në vendngjarje në atë lokacion dhe lëndën e keni sjellë në KK pa vlerësim të komisionit, kjo është shkelje procedurale.

z. Qamil Stagova: Të ky Propozim Vendim Paraprak, prona është e klasës së 3, ne jemi duke e marrë një vendim paraprak në bazë të sugjerimeve të zyrtarëve të ministrisë, mos me i dërguar lëndët direkt në ministri, por KK me marrë një vendim paraprak. Ndërrimin e destinimit të tokave bujqësore të klasës 1-4 e vendosë ministria përpos shqyrtimit të ligjshmërisë.

z. Adnan Reka: Mos është pak si keq të thoni se ju përsëri keni bërë gabim teknik, siç e keni zakon të arsyetoheni, kur i referoheni UA 41/2006, nenit 6 pikës 3 e cila flet për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të kategorisë 5-6, ndërsa qëllimi e anashkaloni pikën 2 të nenit 6, sepse pika 2 flet për tokën e kategorisë 1-4, sikurse rasti jonë në fjalë dhe është tepër e qartë. Është dashur me përmirësuar këto dispozita, pastaj me sjellë lëndën në KK. A e keni shikuar me PZHK ajo tokë a është bujqësore apo ndërtimore? PZHK thotë, ndryshe, ju vepron si të doni, pastaj vendimet na vijnë këtu për shfuqizim.

z. Qamil Stagova: Jo, nuk e kemi shikuar, por aty shihet se ka investime për çështje rekreative, biznesore, turistike, për atë e kemi sjellë këtu. Ne i kemi pranuar sugjerimet e ministrisë, se për ndryshe këto kategori të pronave i vendosë ministria.

z. Besnik Salihu: Në mbledhjen e kaluar ne LDK kemin votuar kundër këto çështje se Betimi ishte me i fushës dhe na tha se kanë me u kthyer këto vendime negative. Pyetje për drejtorin e urbanizmit: Çka dallon kjo pikë nga ato të mbledhjes se kaluar?

z. Qamil Stagova: Të ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në Kaçanik të Vjetër, klasa ndryshon, është e klasës 5 apo 6, ndërrimi final i takon KK, ndërsa qëllimi të kjo shkon vetëm për shqyrtim të ligjshmërisë.

z. Besnik Salihu: Nëse në këtë rast na sfidon ministria e na i kthen, mos po bëhet pak e tepërt, se me kanë pyetur Fidaimi pse e kemi votuar kundër ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, e unë nuk e dija as vet, thash se e kuption në mbledhjen tjetër. Nëse kthehet edhe ky vendim, mos po i mundojmë njerëzit të cilët po bëjnë investime, se ata veç ia kanë filluar me investuar atje. Unë jam me zhvilluar turizmin atje, dhe nuk e trajtoj si çështje politike këtë pjesë.

z. Betim Shala: PZHK mundet me u ndryshua një pjesë e planit kur ka politika zhvillimore të komunës. Për kundër kësaj, ministria nuk lënë me shfuqizuar atë pjesë të PZHK. Unë kam qenë në procese të mëhershme kur ka pasur këso problemesh, ndërkaq ministria nuk lënë me shfuqizuar një pjesë të PZHK. Për të ardhmen, ne duhet me marrë një vendim me zgjidhur këtë çështje, me shfuqizuar pjesën e planit ku të lejon me bërë ndryshime, ose me gjetur rrugën për lejimin e ndërtimeve, sepse në këtë formë si jemi duke shkuar, ata të ministrisë na i kthejnë negativ vendimet.

Kryesuesi i Kuvendit: PZHK është bërë shumë herët, plani i ri është zvarritur shumë, edhe unë kam vërejtje për këtë. Po të ishte PZHK, ne nuk kishim pasur nevojë me votuar fare ndërrimin e destinimeve, por pasi nuk është PZHK, me vendime të veçanta siç e potencuat mundën me u bërë ndryshime kur ka interes komuna, atëherë ne e kemi ndjekur këtë procedurë ka kohë. Është punë e lehtë drejtori mos me pranuar kërkesa për ndërrimin e destinimit, por me punuar në hartimin e PZHK, dhe me u paraparë këto me PZHK. Kërkesave të qytetarëve duhet me iu përgjigjur, disa vendime shkojnë në shqyrtim të ligjshmërisë, e ato paraprake, nuk formohet as komision vlerësues, por ministria merr vendim të veçantë për klasën 1-4. Si procedurë është mirë t'i shtyjmë përpara kërkesat e palëve, por çështja është se disa po kthehen disa jo. E jona është me vepruar sipas vlerësimeve të organit shqyrtyues.

z. Betim Shala: Vota është e lirë, ministria nuk mundet me na mësuar sesi votojmë ne.

Kryesuesi i Kuvendit: Për ne nuk është mirë me u përballë më rishqyrtim të vendimeve, se dalim keq, por çështja është me mirë me iu dhënë një përkrahje qytetarëve, sesa ajo forma tjetër.

z. Adnan Reka: Nuk e kam të qartë prej ekspertëve të ndërtimit dhe atyre të bujqësisë, që thonë se ky plan zhvillimor është për tokë bujqësore, por bënë me destinuar në tokë ndërtimore. Kush është ai autoritet që thotë bënë? Unë nuk di autoritet që thotë bënë apo nuk bënë. Nëse ka plan, duhet me iu referuar planit. Nëse duam me ndryshuar planin, është e mundur, por duhet me planifikuar. Edhe auditori na kishte thënë se krejt rrugët pa plan i keni bërë, kjo nuk është në rregull, dikush duhet të shkoj në përgjegjësi.

Kryesuesi i Kuvendit: Ndërrimet e destinimeve që janë bërë, janë jashtë PZHK, se thuhet në një nen që nëse një zonë është banueshme, i lejohet ndërrimi i destinimit të asaj parcele për me u bërë pjesë e asaj zone të banuar, Betimi e din më mirë. Ne kemi vendime të mbledhjes se kaluar për ndërrim destinimi, disa kaluan disa jo, por çka me bërë, si procedurë duhet zhvilluar çështjen e kërkesave të qytetarëve.

z. Qamil Stagova: **Ne duhet gjetur një bazë, kjo na ve ka lejuar me shqyrtuar.**

z. Adnan Reka: Ne po dalim jo serioz si KK me vendimet që po na kthehen nga ministria.

z. Agim Çaka: Betimin po thotë me e kundërshtar vendimin e qeverisë, ndërkaq unë po themi jo. Ministria kur të kthen një vendim është bazuar në diçka. PZHK është i vitit 2010, kjo na tregon se ne si komunë për do punë kemi ngelur prapa, të cilat probleme po reflektojnë sot. Ne mundemi me ditur ligjin, por nganjëherë nuk ka efekt, se shumica e voton e merret vendimi dhe kjo vazhdon deri në ministri me marrë pëlqimin për më tutje. Kryetari është dashur me

qenë këtu, se krejt debati për këto 2 pikë vlen edhe për 3 pikët tjera, dhe kur të ishte ardhur të pikët që ka konflikt interesit, ka pasur mundësi mos me qëndruar këtu, megjithëse kryetari i ka shërbimet profesionale. Kur një çështje nuk është në rregull, drejtori duhet njoftuar kryetari që mos me proceduar për KK. Ne po diskutojmë këtu se jemi në shërbim të qytetarëve, por për shkak të PZHK nganjëherë nuk po mundem me iu ndihmuar qytetarëve. Këtë problem duhet me zgjedhur, se ne nuk guxojmë me ra në konflikt me ministrinë, se janë procedurat gjyqësore që nuk kemi nevojë me u përballë me to. Planet zhvillimore duhet me u kryer e mos me pasur probleme, sa më shumë vendime që na kthehen, po del se ne nuk i njohim sa duhet çështjet. Duhet të marrim një vendim të përbashkët që kjo punë mos të vazhdoj tutje, se po biem keq.

Kryesuesi i Kuvendit: Deri sa të bëhet PZHK i ri, ne duhet t'i jepim mundësi njerëzve të zhvillohen e të punojnë, por jo duke shkel ligjin, duke përdor të drejtën ligjore me ndërhy në PZHK aq sa e lejon ligji. Arsyetimet e komisioneve janë në propozim vendime, me përjashtim të këtyre paraprake. Shumica e komunave janë në procedura gjyqësore, ndërkaq ne nuk jemi në procedura gjyqësore, se çdo vendim të kthyer nga ministria e kemi rishqyrtuar.

z. Ardit Rrahmani: A kemi mundësi me i pa të gjitha vendimet, edhe ato që janë kthyer pozitiv nga ministria?

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimet me vlerësim pozitiv janë të publikuara në faqe zyrtare se bashku me vlerësimet e ligjshmërisë në organit shqyrta.

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe kur nuk ka qenë LVV në pushtet, kemi anuluar vendime.

z. Naim Beça: Nuk ka nevojë me na komentuar se çka flasim ne opozita, pozita mundet vetëm me na shikuar. Nëse doni e merrni fjalën e dokumentoni atë që besoj unë se është ashtu.

z. Rrustem Zenuni: Ne i mbrojmë interesat e qytetarëve të komunës tonë e jo të komunave tjera.

Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Po e marrë fjalën, por nuk kam dëshirë me më ndërrhyrë se kjo nuk është kulturë. Unë po e shoh edhe në mbledhjet tjera se po dalim shumë nga tema. Shembull konkret, vetëm në pikën 4, diku 90% e diskutimit ishte jashtë temës, përmendimin tim kjo nuk është në rregull. E dyta, krejt e dimë se nuk e kemi PZHK, kjo është hendi i madh, PZHK është në përfundim e sipër, në momentin që është gati del në DP me qytetarë, dhe ju duhet të kontribuoni që të bëhet PZHK me i mirë të komunës. PZHK në një formë është një lloj kushtetute e komunës. Përderisa nuk kemi PZHK, ndërkaq kemi kërkesa për ndërrim destinimi, e drejta e juaj është me dhënë verdiktin përfundimtar. Pajtohem që ka gabime teknike, e tha edhe kryesuesi që ndërrimet e destinnimeve nga 1-4 shkojnë direkt në ministri, ndërkaq 5-6 shqyrtohet ligjshmëria në ministri. Nëse është një pikë për zhvillim ekonomik që gjeneron vende të reja të punës, është e jona me përcjellë në ministri, ndërkaq a e lejon apo jo ministria, është çështje tjetër.

z. Adnan Reka: Ne e kemi një PZHK të vjetër, ministria po i referohet këtij plani dhe ne duhet me iu përbajtur këtij plani derisa të bëhet plani i ri. Ndërrimet e destinnimeve nga 1-4 UA është shumë i qartë, 6.2 thotë ndërrimi i përhershëm i destinit 1-4 bëhet më vendim komunal pas marrjes së pëlqimit nga ministria, ndërkaq ne po veprojmë të kundërtën, faktikisht ne po e anashkalojmë ligjin dhe i referohemi pikës 6.3 e jo dispozitës që e rregullon këtë çështje.

z. Qamil Stagova: Ata të ministrisë kanë kërkuar nga ne me vepruar kështu. Është e vërtetë se ligji thotë ashtu si po e potenconi ju z. Adnan, por ne për qëllim me të mirë me kryer punë po veprojmë në këtë formë.

z. Betim Shala: Unë po e shoh vendimin e ministrisë që ka dhënë vlerësim pozitiv për një vend që me PZHK është vendbanim, e këto tjerat që nuk ka qenë vendbanim, janë negativ. Për ato

që është me PZHK vendbanim nuk ka pasur nevojë fare me ardhur në KK, kështu që sipas meje nuk pritet me u kthyer pozitiv as ky vendim.

Kryesuesi i Kuvendit: E dini edhe ju Betim se edhe në Kaçanik për shumë prona janë me PZHK toka bujqësore, këto janë defekte të kaluara, pasojat e tyre po i vuajmë tani.

z. Agim Çaka: Vendimet e kësaj natyre kanë specifika të ndryshme, kështu ministria vendllojë sipas vlerësimeve të saj në bazë të PZHK. PZHK i vjetri vlen deri sa të bëhet PZHK i ri. Ne nuk e kemi mundësinë e votimit “Pro me kusht”, se pasur, unë jam për qytetarin me ia lejuar ndërrimin e destinimit, me kusht që është brenda kornizës ligjore vendimi që e marrim.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjtë u aprovua me 14 votë Për, 10 Kundër, Abstenim 1. Pjesëmarrës në votim ishin 25. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i komunës mori këtë:

VENDIM PARAPRAK

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale 01208-2, Mal i klasës 3 në sipërfaqe 504m² dhe livadh i klasës 3 në sipërfaqe 1722m² në emër të Nexhmedin (Mustafa) Elezi nga f. Sllatinë/ Lënda: 01Nr. 06-350/02-12630/22.

5. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 00729-8 zona kadastrale Bob, në vendin e quajtur “Oborr”, Arë e klasës 6, pronë e Blerim (Ajet) Çaka nga Bobi-Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Adnan Reka: Ne do të jemi për, sepse situata të ky propozim vendim është pak me ndryshe, sepse ky shtëpinë e ka në atë vend nga paralufta, kemi konsideratë për keq planifikim apo keq drejtshkrim apo gabim teknik.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjtë u aprovua njëzëri. Pjesëmarrës në votim 25. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 00729-8 zona kadastrale Bob, në vendin e quajtur “Oborr”, Arë e klasës 6, pronë e Blerim (Ajet) Çaka nga Bobi-Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 06-350/02-16605/22.

6. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 350m² në parcelën kadastrale 02302-2 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur “Shoko bare kalishtë” në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, nën qiramarje 99 vjet;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Është për të përshëndetur kjo kërkesë e parashtruesit e adresuar me datën 18, fleta poseduese po me këtë datë është nxjerrë, në të njëjtën ditë komisioni ka dal në vendngjarje, kjo parcelë është dhënë nga AKP për 99 vjet, kurse personi në fjalë e ka marrë me kontratë mbi qiranë për 99, për 5 vite kanë qenë mangut, ndërkaq pas 5 viteve përsëri e ka marrë për 99 vite.

z. Qamil Stagova: Është e vërtetë se kjo lëndë është përshpejtuar me qenë në rend pune në mbledhjen e kaluar, por pas bisedave me kryetarin dhe kryesuesin, e kemi lënë për këtë mbledhje, kjo është puna e datave.

z. Agim Mani: Brenda 1 dite është kryer krejt procedura pa u analizuar mirë. Po të ishte analizuar mirë, se ajo është një kontratë prej AKP, nëse pronari nuk mundet me realizuar kontratën që e ka pasur me AKP, prona duhet t'i kthehet AKP e jo t'i epët me qira, se personi në fjalë ka bërë kërkesë për lokal afarist-për biznes.

Kryesuesi i Kuvendit: Janë këto prona kah Fusha e Pajtimit, kah Mani- Ballkan Petroli që shumica e tyre janë shitur prej AKP, kanë qenë prona të pronarëve me herët. Nuk e di formën si i kanë kthyer, si do që të jetë, janë procedura që janë privatizuar ato prona dhe janë kthyer përsëri të pronari, qysh e kam dëgjuar. Janë edhe parcela tjera që janë shitur në këtë formë, një ka qenë e Qorrit, që iu ka lejuar ndërrimi i destinimit në legjislatoren e kaluar.

z. Adnan Reka: Vërtetë ju këtë Kuvend e keni shndërruar në një institucion jo serioz, sepse të gjitha vendimet e kundërligjshme të cilat ju po i merrni për interesa individuale apo grupore, i kaloni përmes këtij Kuvendit për t'u fshehur nga vendimet e dëmshme për interesin publik. Kuvendi nuk është inatçiu për t'i kamufluar vendimet. A nuk janë mjaftë të qarta 3 vendimet e fundit të MBPZHR për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, që na i kthyen mbrapa si vendime kundërligjore, sepse në PZHK të miratuar në vitin 2010 këto toka ishin të destinaura për bujqësi, dhe nuk mund t'ju ndërrrohet destinimi tokave kurdo që dikujt i konvenon. Të nderuar asamblistë, unë ju ftoj të mos bini pre e këtyre vendimeve kundërligjore që e turpërojnë këtë Kuvend, sepse ne me vetëdija apo pa vetëdije po bëhem i një lloj palaqoje e ekzekutivit.

Kryesuesi i Kuvendit: Të PZHK 2010, ka pasur kërkesa të qytetarëve dhe përmes meje i kemi futur në PZHK nga Fusha e Pajtimit- Pishina Medi si zonë ekonomike për zhvillimin e bizneseve. A e dini sa lehtësira kanë ata sot sa i përket procedurave. Një mundësi e tillë duhet me pasur edhe këta tanë, zhvillimi ekonomik ka orientim në atë pjesë, se janë vende të duhura për investime.

z. Adnan Reka: Kam pyetje për drejtorin e bujqësisë dhe drejtorin e urbanizmit: Çfarë plani keni ju që jeni duke hequr dorë nga toka bujqësore, jeni duke kërkuar në vazhdimësi me i shndërruar në toka ndërtimore? Cili është plani i juaj, tregoni planin, se nuk mundesh me ndërtuar shtëpinë pastaj me ia ndërruar destinimin pronës?

z. Qamil Stagova: Drejtoria kur ka vendosur, e ka pasur parasysh lokacionin sa është me lokale e objekte në atë kuptim e ka dhënë këtë propozim.

z. Adnan Reka: A ka ndonjë përgjegjësi për ato lokale të cilat janë ndërtuar aty ? Askush nuk ua ka ndërprerë punimet për ndërtimë në toka bujqësore.

z. Qamil Stagova: Ka me leje e ka pa leje ndërtimi. Aty ku është dhënë leje janë të kundërligjshme, sepse nuk e lejon PZHK.

z. Adnan Reka: A mundet me u dhënë leje ndërtimore në një vend, ku ligjërisht është i ndaluar? Me dhënë lejen ndërtimore pa e shndërruar tokën në bujqësore në ndërtimore, kjo nuk është në rregull.

z. Qamil Stagova: Me më pyetur mua, një vend që është i mbushur me ndërtimë, unë jap leje, për këtë arsy e kam sjell këtu, se nuk kam të drejtë me dhënë leje.

Kryesuesi i Kuvendit: Objektet afariste nuk munden me funksionuar asnëjëra prej tyre që janë aty, pa pasur leje ndërtimore. E dyta, nuk ka leje ndërtimore pa pasur ndërrim të destinimit të tokës. Ato biznese që janë aty, ka njerëz të punësuar, ka zhvillim, ne identifikohemi si Kaçanik me këto biznese.

z. Rrustem Zenuni: Desha me u lidhur me diskutimin e kolegut, Agimi, po tenton në atë se KK i ka dhënë pronat për 99 vjet. Është AKP që i ka i ka dhënë në shfrytëzim ato prona. Nuk është çështje e jonë se a e ka përbushur kontratën ai i cili e ka marrë pronën në shfrytëzim nga AKP apo jo.

z. Agim Mani: Ne e dimë qysh i kanë marrë pronat në atë kohë nga AKP. Pronat janë shitura, pastaj janë marrë me qira nga tjetri. Me tregon ti mua, cili është interes i publikut në këtë rast? Interesi është i atij që e ka blerë është me bërë biznes privat. Kjo tokë nuk ka qenë e tij.

z. Rrustem Zenuni: Interesi është se ai biznes krijon të hyra, krijon punësim. Çfarë interesit jetët sheh ti nga ato djerrina?

z. Agim Çaka: Çështja se a e ka marrë në formë të ligjshme apo jo atë pronë, është punë e kryer, mos të kthehem prapa tani. E jona është me debatuar, a me ia lejuar ndërrimin e destinimit apo jo asaj prone. Gabimet që i kanë bërë me herët, nuk duhet me u marrë me to. Nuk po e shikoj si person kush është, temat janë specifike, nuk guxojmë ti vlerësojmë në paketë. Unë të e para isha Për, se shtëpia është në oborr, a ka leje apo jo a është me PZHK a jo, është përgjegjësi të komunës. PZHK është i viti 2010 dhe ne jemi duke punuar me këtë plan dhe ministria po lidhet në këtë plan, problemi është se, a është i mirë ai plan apo duhet me bërë PZHK të ri, normal duhet me bërë planin e ri, se Kaçaniku nuk është i viteve 90 që nuk ka pasur as KK as nuk i ka pyetur kush, për këtë ne jemi këtu dhe duhet me u gëzuar që mundemi me bërë punë të mira. Problemi është se ai duhet me na arsyetuar se çka donë me bërë në atë vend dhe a është brenda ligjit. Qëllimi është të vijmë në një pikë të përbashkët e mos të inatosemi me njëri tjetrin për shkak të subjektit politik apo të ngashme. Duhet të thirremi në parime, të thirremi në ligj, unë jam mos të bëhem pengesë. Nëse ne gabojmë këtu, është dikush tjetër që na e kthen e pastaj pasojat e vendimeve të KK apo ekzekutivit, mund ti shtrojmë në debate për vendime të tilla.

z. Adnan Reka: z. Agim Çaka, PZHK ekziston dhe ne nuk po themi se duhet ti përbahemi atij plani, se në të kundërtën është kundërligjore. Para kësaj mbledhje ti na ke thënë se nuk është mirë me marrë kësot vendimesh se PZHK nuk e lejon. Unë thashë, ne që nuk po e dimë po abstenojmë e ju që po e dini është mirë me marrë vendime të kundërtta, e ju përkundrazi morët vendim edhe pse e ke ditur se PZHK nuk e lejon. Ti me vetëdije po e shkel ligjin, është e drejtë e juaja.

z. Agim Çaka: Unë edhe në nëse mbledhjet e kaluara kam thënë: Diçka që e di se është në kundërshtim me ligjin, unë nuk e votoj. Nëse është i paqartë, unë abstenoj. Nëse është në rregull, votoj për. Nuk kam thënë që një çështje që është në kundërshtim me ligjin do të votoj Për.

z. Rrustem Zenuni: Kërkoj që të votohen në paketë kjo pikë me 2 pikët tjera vijuese.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështjet janë të veçanta, nuk ka votim në paketë. Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 16 votë Për, Kundër 6, Abstenim 3. Pjesëmarrës në votim 25. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 350m² në parcelën kadastrale 02302-2 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Shoko bare kalishtë" në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, nën qirimarrje 99 vjet / Lënda: 01Nr. 06-350/02-13415/22.

z. Ardit Rrahmani: Kërkoj që KK me bërë pasuse, pastaj me vazhduar me pikët tjera,

Kryesuesi i Kuvendit: Ti kryejmë edhe këto 2 pikët për ndërrim destinimet, pastaj bëjmë një pauzë. Kalojmë në pikën vijuese:

7. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 001334-13 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Perovina", në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër;

E hapi diskutimin:

z. Agim Çaka: A është parcella në të njëtin vend ku ishte parcella për pikën paraprake?

Kryesuesi i Kuvendit: Parcella është në vend tjetër, ndërkaq personi është i njëjtë.

z. Qamil Stagova: Personi është i njëjtë, ndërkaq vendi jo. Në atë parcelë me PZHK ekzistues parashihet vendbanim.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për, 6 votë kundër, Abstenuan 4 anëtarë. Pjesëmarrës në votim 25. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 001334-13 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Perovina", në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër / Lënda: 01Nr.06-350/02-16695/22.

8. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 001334-12 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Perovina", në emër të Burim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër;

Kryesuesi i Kuvendit: Është i njëjtë vend si të pika 7, prona është në të njëtin vend, ndërkaq ata janë vëllezër, kanë kërkuar me iu ndërruar destinimi pronës me ndërtuar shtëpi. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua 15 votë Për, Kundër 6, Abstenim 4. Pjesëmarrës në votim 25. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 001334-12 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Perovina", në emër të Burim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër / Lënda: 01Nr.06-350/02-16696/22.

Pas kësaj pike KK bëri një pauzë 15 minuta, ndërkaq pas pauzës u vazhdua me pikët e mbeturat;

9. Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2021;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Adnan Reka: Para se të filloj diskutimin e Raportit të Auditimit dua ta pyes diçka Kryetarin, Kryetar, cili raport është më i keq, kur kemi opinion të pamodifikuar të auditorit me theksim të çështjes, apo opinion të kualifikuar të auditorit? Pra, siç e kuptuat këtë vit kemi një raport edhe më të keq të auditorit, për faktin se kemi opinion të kualifikuar të auditorit. Çka do të thotë opinion i kualifikuar? Opinion i Kualifikuar formulohet kur auditori zbulon keq-deklarime ose sh 'përputhje në pasqyrat financiare, qoftë një i vetëm apo grumbull të keq-deklarimeve. Ndërsa ne edhe këtë vit fatkeqësisht kemi mjaft keq-deklarime apo sh përputhje në pasqyrat financiare. Të fillojmë nga: Faqe 7 - Çështja A1 - Keq klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve nëpër kategoritë

ekonomike në vlerë 104,879 €. Nga kategoria investimet kapitale janë paguar 87,562€ , për mirëmbajtjen teknike të objekteve komunale dhe riparimin e objekteve shkolllore, të cilat sipas udhëzimit administrative konsiderohen mallra dhe shërbime. Ndërsa, nga kategoria mallra dhe shërbime vlera 15,637€, ishte paguar vendimi përmbarimor për shpronësimin e tokës, shpenzime këto që i takojnë investime kapitale. Është interesant se komuna kishte bërë të njëjtën gjë edhe vitin 2019 edhe 2020. Auditori kishte gjetur se, Komuna me vendime gjyqësore gjatë vitit 2020 kishte paguar dhe regjistruar shpenzimet në vlerë prej 334,268 € në kategorinë ekonomike joadekuate, prandaj edhe kishim theksim të çështjes. Nga investimet kapitale kishte paguar për arsim, ndërsa nga mallra dhe shërbime kishte paguar për shpronësim. Faqe 8- Çështja A2 - Regjistrimet e gabuara të pasurive kapitale Auditori gjen se, pasuritë kapitale në RVF ishin të mbivlerësuara për 101,407€, pagesat janë bërë për renovimin e objekteve shkollore, renovimin e objekteve banesore, furnizim me oksigjen, furnizim me inventar për shkolla dhe servisim të automjeteve. Dhe ju sigurisht se fare lehtë mund ta kuptoni pse janë kinse këto gabime. Faqe 9, Çështja C1 -Nënvylerësim i detyrimeve kontingjente Detyrimet kontingjente të prezantuara në RVF janë të nënvylerësuara për 414,546€. Edhe vitin e kaluar auditori kishte gjetur se, Vlera e detyrimeve kontingjente të pazgjidhura në vitin 2019 nuk ishte bartur në kolonën e vitit 2020, do të thotë një gjë e tillë bëhet me qëllim për ta kamufluar buxhetin, që të mos kuptohet se sa para harxon komuna jonë vetëm në dënlime të ndryshme. Faqe 10, Çështja A3 -Tejkalim i kontratës publike kornizë. Auditori gjen se, dy kontrata kornizë kanë tejkalim të vlerës së kontraktuar "Mirëmbajtja verore dhe dimërore" është tejkaluar për 134,930€, dhe kontrata "Rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal" është tejkaluar për 18,265€. Edhe në vitin e kaluar auditori kishte gjetur se kishim dobësi në menaxhimin e kontratës, siç ishte Rr. Avdurrahim Shehu Çështja A4 - Mungesa e projektit ekzekutues Auditori thotë se, në katër raste kemi vërejtur se Komuna ka lëshuar dokumentacionin e tenderit pa hartuar projektin ekzekutues. Rastet ishin te kontratat Ndërtimi i shtegut të çiklistëve dhe trotuarit në fshatin Shtrazë në vlerë 86,167€, Rregullimi i trotuarit Bob-Doganaq në vlerë 134,334€, Rregullimi i ndriçimit publik në vlerë 73,555 €, dhe rehabilitimi i rrugës Qamil Ilazi dhe Sali Bajra në vlerë 259,937 €. Do të thotë pa plan e pa projekt i marrin tenderët.

Faqe 11, Çështja C2- Mos verifikim i plotë i pronave komunale Ligji parashev që Komuna duhet të bëjë verifikimin së pakun e 20% të pronës së paluajtshme komunale, komuna jonë ka arritur të bëjë verifikimin e vetëm 6% të pronës, kjo është edhe më keq edhe se vitin e kaluar kur kishim 13% verifikim të pronave. Faqe 12, Çështja B1 - Dobësi në menaxhimin e pasurive jo kapitale. Auditori gjen se 4 pagesa në vlerë prej 21,290 € nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria, mos regjistrimi i plotë e tyre ndikon që pasurit jokapitale të mos raportohen në pajtim me kërkесat ligjore. Të njëjtën gjë auditori kishte thënë edhe në vitin paraprak, pasuritë e blera nën 1,000 euro gjatë vitit 2020 nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria për 60,466 €

Pra, gjetjet dhe rekomandimet e auditori janë: tejkalim i kontratave publike kornizë, mungesë e projekteve ekzekutive, prezantim jo i drejtë i detyrimeve kontingjente, keq klasifikim i shpenzimeve, dobësi në regjistrimin e pasurive. Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur sidomos me rastin e përgatitjes se Raportit Vjetor Financiar. RVF për vitin e përfunduar më 31.12.2021 nuk ishte në pajtim me Rregullat Financiare, Raporti ishte jo i saktë, thotë auditori.

Dhe, krejt në fund dua të them se, nuk është se ky Raport i Auditimit ka më shumë të gjetura se Raportet e viteve të kaluara, por Auditorët tani janë më serioz, dhe besoni që unë nuk jam i kënaqur që Komuna e Kaçanikut ka raporte financiare të pa sakta, por vërtet jam i kënaqur që shteti ka filluar të funksionojë, sepse në raste të tillë nuk do të duhej ta kishim vetëm auditorin këtu, por do të duhej ta kishim edhe prokurorin.

Kryetari i Komunës: Adnan faleminderit, pjesërisht pajtohem me ty, me vjen mirë që i ke kuptuar opinionet. E dyta, pajtohem në dy pika prej këtyre që i potencove: Kontrata kornizë dhe mungesa e projekteve. Ne e kemi një lloj arsyetimi moralisht po themi, sepse të kontratat kornizë janë kontratë me njësi dhe shuma, gjë që me njësi dallohet 30% gjë që unë nuk e kam

ditur. E dyta; mungesa e projektit që pajtohem plotësisht të rruga: "Qamil Ilazi" për tjerat nuk pajtohem, si të trotuaret, të ndriçimi publik që 20 vjet i bëjmë të njëjtë gjëra, me pas pyetur, nuk isha pajtuar, megjithatë e kërkon auditori dhe duhet me u përshtatur. Për me kuptuar që auditori nuk është shumë serioz, 3 komuna të juaja që qeverisni që i akuzonit shumë, Kamenicë, Shtime, kanë dalë me opinion të mirë. E kuptojmë se kanë me hyrë në garë sivjet, në rregull është, qeverisjet ndryshojnë, auditori ka ndryshuar dhe e kemi ditur paraprakisht. Të tjerat, të shuma keq klasifikimi 100.1000€ të MSH, që 20 vjet shkollat i rinovojmë me Investime Kapitale(IK), tani del auditori dhe thotë me Mallra e Shërbime (MSH). Ne e dimë se buxheti aprovohet 1 vit përpara dhe e dimë se kulmi nuk është me MSH, plloqa në shkollë nuk është MSH, por na detyron me i bërë në vitin vijues. Ne fillim shpenzimet e varrimit i kemi bërë nga MSH, vjen auditori dhe na thotë se është keq klasifikim dhe unë vitin tjetër e paraqes në subvencione dhe transfere. Kur vjen auditori tjetër thotë e ke keq se duhet me qenë nga MSH, prapë e kam kthyer në MSH. Unë kam me vepruar ashtu siç thonë. Detyrimet kontingjente, nëse ka të gjetura, atëherë unë shkoj në prokuroi, por nuk ka të gjetura, se nëse ka, kjo është element për hetuesi. Mua me paditë qytetari, ne e kemi një marrëveshje me Bashkim Topojani me 20% të shumës për komunën tonë për projektin, pas pranimit teknik thuhet se 20% i takon komunës. Ne nuk mundemi me përcjellë se çka bënë, ai i ka shitur edhe do prona që i takojnë komunës të cilat janë në kontest gjyqësor dhe ia kanë paguar Bashkim Topojanit 37.000€ banesën, por në gjykatë thotë se e kam paditur komunën për 5 banesa diku 130-140 000 €, dhe këto nuk mund t'i parashoh si shpenzime kontingjente, se asnjëherë nuk kanë me u bërë. Ne i kemi paraparë shpenzimet kontingjente, ato që mendojmë se ai i dëmtuari mundet me na i nxjerrë sikur vitin e kaluar që e kemi pyetur auditorin për këto shpenzime kontingjente, na ka thënë se nuk ka nevojë, ndërkaq auditori tani thotë, krejt çka të shkon në gjykatë duhet me paraparë këtu, ku sipas tij 500-600.000 € duhet me i lënë për këto shpenzime, sikurse ishte rasti të Tushët, janë lënë mjetet, ndërkaq pas 8 viteve janë ekzekutuar. Unë edhe në vitin e ardhshëm nuk planifikoj mjete për këtë, sepse nuk është ndonjë shkelje që e dëmtoj qytetarin ose komunën, se ato që vijnë janë të parapara edhe për 2 vjet me i ekzekutuar. Nëse mua me vjen sivjet, unë e parashoh me ekzekutuar në vitin vijues të përmbaruesi. Të shuma nën 1000 €, është parregullsi që 20 vjet, jemi duke e përmirësuar, vitin e ardhëm nuk besoj se ka me pasur. Nëse kishte me qenë real ky opinion, unë kisha me shkuar në prokurori, por me se paku që mund të akuzohem është kjo këtu, se është me tendencë. E mora shembull QKMF në Kaçanik, sipas teje QKMF nuk e kisha ndërtuar, janë 4 kontraktues 4 investitor, me marrëveshje në kemi bërë me ministrinë dhe Karitasin e Luksemburgut, procedurat me i udhëhequr Karitasi i Luksemburgut. Ata kanë kërkuar që mjetet paraprakisht të zotohen, pastaj me i ecur procedurat e prokurimit, që ne nuk e kemi të drejtë ligjore. Dy vjet ka qenë raporti i auditorit me theksim të çështjes për këtë. Mos me pas shkuar në këtë formë, QKMF nuk ishte ndërtuar fare, i kam shkelur rregullat, jam ndëshkuar si komunë, por ka përfituar qytetari. Të përqindja, ne DEF me mungojnë 4 zyrtarë, ia kam sqaruar se nuk kam udhëhequr që 4 vjet procedura të prokurimit, me çka me i kryer ato ri anketime pa zyrtarë. Me tha po e di, po ligji i shërbyesve civil iu ka ndëshkuar. Sivjet i kam udhëhequr procedurat, nuk ka me pasur me të gjetura në këtë drejtim.

z. Rrustem Zenuni: Duhet me u bërë realist, në rrugën: "Ismajl Raka" kush i ka udhëhequr procedurat?

z. Bahri Selimi: Krejt ky opinion i raportit, ndikon në grantin e përformancës se ne përjashtohemi prej garës. Në anën tjetër, sikur ti Adnan po mi lexon ku po të konvenon, edhe unë po ti lexoj ku me konvenon. Neve na intereson mjetet e vitit 2021 a i kemi shpenzuar në formë të rregullt, për këtë rrimë rehat. Sipas opinionin të auditorit përvëç ndikimeve të jashtme të përshkruara në paragrafin për bazën për opinion të kualifikuar, pasqyrat vjetore financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me standartet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik. Tani janë renditur do të gjetura; të keq klasifikimi, kemi me pasur përsëri se i ekzekuton disa thesari lëndë me vendime preliminare, shkon në gjykatë dhe thesari e ekzekuton në MEF aty ku ka mjete të lira, ku na

konvenon neve. Aty ku bien në atë kategori mos me figuruar keq klasifikim ne i lëmë kah fundi vitit se nuk ke mjete. U përmend 15.000 €, e dimë se ka pasur me një shpronësim, janë marrë të SHK aty ka pasur mjete të lira, 90% e mjeteve janë nga GQ dhe ministria i merr kurdo. Auditorët që the se janë më serioz, për ne janë me tendencioz, pse u ndërruar atëherë auditori gjeneral i ZKA? Janë disa komuna: Shtimja, Kamenica, Podujeva, auditori i ka klasifikuar mirë, megjithëse përsëri ka me pasur probleme Në 2020 opinioni ka pasur keq klasifikim dhe kemi marrë opinionin e pamodifikuar-pakualifikuar me 300 mijë euro. Sivjet si bazë me dalë me na i prishur raportin ka qenë, keq klasifikim për 100 e 5 mijë euro. Është pak me tendencë, por nga aspekti i shpenzimit të parasë publike jemi më mirë, nuk bëhemë për merak për këtë që e tha edhe kryetari, se rapporti i auditorit është element hetuesie, nuk merakos për atë punë, nëse ka diçka serioze ata merren me neve. Ne rrimë rehat për këtë punë.

z. Adnan Reka: Sa i përket komunave që u përmenden, unë nuk merrem me komunat tjera, unë jam këtu në këtë komunë dhe flas për komunën time, ato komuna që u përmenden se kanë dalë mirë, me vjen mirë që kanë dalë mirë. Sa i përket raportit, me vjen keq që keni dal keq, a ka filluar me funksionuar shteti, jam i lumtur që ka filluar. Sa i përket heqjes se auditorit gjeneral, qenka hequr dhe ne kështu presim, prandaj me u hequr dhe me filluar me punuar si duhet. Keq klasifikimet po thoni se nuk i kemi bërë e unë ndoshta nuk i kam kuptuar, por a po e kuptoni se është shkelje ligjore se e përmendem edhe të urbanizmi, se pari po ndërtohet shtëpia pastaj ia bënë planin, kjo nuk është në rregull. Edhe këtu procedurat e tenderit pa projekt ekzekutues në rrugën Sali Bajra e Qamil Ilazi, kjo nuk është në rregull. Po lyp zgjidhje prej auditorit, po lyp zgjidhje prej neve se qysh kishim vepruar ne. Ju duhet me bërë zgjidhje kryetar e jo ne. Ju duhet as mos me shkelur ligjin dhe me i bërë punët si duhet. Nuk po i bënë punët si duhet e po thoni se jo unë e shkeli ligjin, në rregull, shkele ligjin, por ne e kemi ditur se përfomancën ke me pasur me të dobët për shkak të ndërrimit të pushtetit.

Kryetari i Komunës: Adnan po me vjen mirë që po thoni se ka filluar me funksionuar shteti, po pajtohem plotësisht, por çështja është si dolën komunat që janë akuzuar shumë, me përfomancë me të mirë. E dyta, ne nganjëherë nuk kemi qare pa i shkelur do ligje nga pak për një arsy. Sipas teje, a ia ka vlejtur me ndërtuar QKMF apo jo? Është shkelje dhe 2 vjet për këtë kemi pasur vërejtje të auditori. E treta, po thua shpenzimet kontingjente me lënë ashtu hipotetikisht po e themi, të Tushët në vitin 2012 ka ardhur vendimi i gjykatës, ndërkaq është ekzekutuar në vitin 2020. E treta, çka me i thënë kësaj, 1 vjet mallrat dhe shërbimet të shpenzimet e varrimit është keq klasifikim, në vitin tjetër prapë subvencionet janë keq klasifikim dhe me kthen prapë, çka me i thënë Adnan kësaj pune.

z. Rrustem Zenuni: Duhet me u bërë realist e me treguar, në rrugën "Ismajl Raka", kush i ka udhëhequr procedurat?

z. Adnan Reka: Në rrugën "Ismail Raka" procedurat i ka udhëhequr USAID. Me herët shumë mirë Kemali e përmendi, në nuk mundem me bërë shkelje në KK, duhet me i shfuqizuar vendimet se komuna shkon në procedurë gjyqësore e jo unë për mosbatim të vendimeve. Sugeroj me i respektuar ligjet, edhe një kërkësë që e përmendi në fillim Arlinda të ndërtesa pas shtëpisë së kulturës me u rinovuar, edhe auditori të ka thënë për këto se për këto keq punime keq menaxhime çka dush thuaj, ai objekt aty edhe pse është tenderuar edhe pse janë dhënë mjetet, ajo ndërtësë nuk është prekur fare.

Kryetari i Komunës: Keq klasifikim ka thënë auditori me MSH me i paguar mjetet. Sivjet kanë me filluar ato objekte, se po i ngatërron gjërat. Ne kemi filluar, është viti i tretë, në vitin e parë janë bërë këtu, në vitin e dyte është bërë banesa për vlerësim, në vitin e tretë është banesa të objekti të stacioni i autobusëve, por mua ma ka shënuar keq klasifikim se nuk bëhen me IK por me MSH, gjë që unë e kam bërë që dy vjet. Buxhetin është aprovuar në shtator me atë kod,

tani duhet me gjetur me i proceduar nga MSH me tjetër procedurë, nuk janë proceduar mjetet pa u punuar, tani pritet të tenderohet.

Kryesuesi i Kuvendit: Duhet të mësohemi me folur për problemin. Nëse mendojmë si institucion, nuk ka vlerësim tendacionz kur ka shtet funksional. Ka ndryshim të qasjes së pushtetit, ama funksionalizimi dhe mos funksionalizim të shtetit nuk ka. Munden me u ndërruar qeveritë, por shteti funksionon kushdo që vjen në pushtet. Tani po e njihni shtetin se deri dje nuk e keni njohur as shtetin, mirë është që po funksionon shteti, shpresoj të funksionon si është më së miri, por nuk ka vlerësime tendencioze, se tani ne jemi dhe funksionojmë mirë, shteti ka me funksionuar me neve dhe pas neve se është bërë shumë me u ndërtuar ky shtet, u derdhur shumë gjak dhe ka me funksionuar pavarësish kush vjen në pushtet, ndërkaj mënyra e qeverisjes ndryshon. Auditori është organ i pavarur dhe nuk dua me as me besuar që mundet auditori me u ndikuar prej pushtetit. Shpresoj së nuk është asnjëherë ashtu, kushdo që është në pushtet, auditori duhet me kryer punën e vet. Të Raporti i auditorit, është rubrika ku ekzekutivi i ka dhënë opinionet e vetës për secilën të gjetur. Të çështjet e theksuara, kushdo që është në pushtet, mos mendoni se ka me ardhur raporti i auditorit pa asnje të gjetur, ka me pasur të gjetura, keq klasifikim, se është puna që të bënë me bërë keq klasifikime. Është e çuditshme që me një raport të një auditori për një çështje të caktuar thuhet ndryshe, vitin tjetër ndryshe. Auditori duhet trajtuar çështjet njësoj, pavarësish kush është auditor. Ka keq menaxhim që ceket edhe në raport, kryetari duhet me i pasur parasysh të gjeturat. Është fat i mirë që ne çdo herë kemi marrë raporte të mira, këtë herë raporti është pak me i keq, duhet vendosur mendjen vetës, pajtohem me këtë, por nuk bënë me thënë se këtu është çdo gjë dallavere, çdo gjë është keq klasifikim, çdo gjë është keq. Duhet ti marrim gjeraç ashtu si janë, pa iu gëzuar dhimbjes se dikujt as pa u lavdëruar në atë se bëra diçka. Raportet e auditorit janë raporte të pavarura, duhet trajtuar ashtu diç janë, pavarësish edhe kryetari e potencoj se pajtohet me raportet e auditorit me të gjeturat që i ka cekura. E kemi detyrim, por jo me u thirrur në atë se na i ka bërë me qëllim, ose me thënë se ne kemi ardhur tani dhe ne jemi duke ua gjetur shkeljet, kjo është gabim total. Janë raporte të pavarura dhe duhet trajtohen si raporte të pavarura, pa e marrë askush lavdin as pa u arsyetuar askush. Të arsyetimi që u dhanë janë me të vërtetë të dallueshme, sepse për çështje të caktuara kemi opinione të ndryshme, nuk dinë si me vepruar, sipas auditorit të vjetëm, të parvjet apo atij të sivjetmë. Ata janë të detyruar me na treguar se a kemi me vepruar sipas ligjit, asnjeri nuk po na tregon drejtë, këto nuk janë shumë të qarta për ne.

Diskutime tjera nuk ka, Raporti i auditorit nuk del në votim, konstatoj se Kuvendi diskutoj, **Raportin e Autitorit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 470/03-16853/22,**

10. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve në raportin e auditimit të dhënë nga ZKA, për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Adnan Reka: Unë dua të jap një pasqyrë të zbatimit të rekomandimeve të auditorit ndërvite, që ta shohim progresin e komunës tonë. Për vitin 2015, nga 13 rekomandime të Auditorit, vetëm 2 janë zbatuar. Për vitin 2016, nga 24 rekomandime të Auditorit, vetëm 9 janë zbatuar, Për vitin 2017, nga 13 rekomandime të Auditorit, vetëm 5 janë zbatuar, Për vitin 2018, nga 11 rekomandime të Auditorit, vetëm 4 janë zbatuar, Për vitin 2019, nga 10 rekomandime të Auditorit, vetëm 5 janë zbatuar Për vitin 2020, nga 6 rekomandime të Auditorit, vetëm 3 janë zbatuar. Pra, kjo nuk quhet progres sepse ju kurrë nuk keni arritur të zbatoni më tepër se gjysmën e rekomandimeve të Auditorit Kombëtar.

z. Bahri Selimi: Zbatimi nga 10 të gjetura, 5 nuk shkon, zbatimi rrokë më gjatë, keq klasifikimi të mirëmbajtja e shkollave, në atë gjetur ka rrjedhur edhe e gjetura tjetër ku thotë; pasuritë

kapitale janë mbivlerësuar. Katër të gjetura që dalin 2 apo 3 si rrjedhojë e njërsës, kur të zbatohen përqindja eshtë më e madhe, nëse e kemi zbatuar një për një. Të freskëta i kam ato të viti 2020 janë zbatuar 83.33% nga 6 të gjetura. Unë kam thënë 90%, por auditori thotë 83.33%, janë vlerësimë që na i jep auditori e ne po i marrim nga viti 2015. Shënimet i kemi dhe mundem me një listë secilin vit si ka shkuar progresi.

z. Adnan Reka: Unë nuk i kam llogaritur në përqindje, por sa të gjetura janë zbatuar. Auditori ti jep me numër të gjeturat dhe me numër duhet përgjigji.

z. Agim Çaka: Po ndërlidhem me vërejtjet e auditorit, normal se auditori e vlerëson punën dhe ia jep vërejtjet e veta, mirëpo të gjitha këto merren parasysh edhe kur të bëhet vlerësimi i përformancës të komunave. Komuna jonë para pak kohe ka dal bukur mirë me përformancë dhe e ka përfituar grantin qeveritar. Tani kur nuk të vlerëson mirë, të njëjtit njerëz janë aty, e njëjtë qeveri eshtë, edhe pse jemi opozitë, nuk kam dëshirë me parë në këtë pozitë të vështirë kryetarin me vërejtje të shumta të auditorit. Ne i kemi të qarta gjérat, shpresojmë të bëhet reagimi i përformancës edhe këtë herë, mos të shkohet në formë tendencioze, nëse ke ndonjë farë ndikimi, me shkuar në nivel qendror dhe me thënë se çdo gjë që bëhet mirë, bënë për interesin tonë. Nuk bënë me i shikuar gjérat në vinë partiak, e me i ngritur temat e nivelit qendror këtu, me akuzuar qeveritë e kaluara. Edhe qeveria në pushtet, nuk janë duke bërë asgjë Adnan, se kurrë me afër nuk kemi qenë me afër liberalizimit të vizave, por për shkak të skandaleve të kësaj qeverie, vizat nuk u liberalizuan. Çështja se rruga nuk eshtë shtruar sot, shtrohet nesër, ndërkaj janë do punë më të mëdha në interes tonë dhe duhet me u kryer dhe obligimi dhe përgjegjësia eshtë e krejt kësaj qeverie, se ata çka kanë qenë me herët nuk i kanë gjetur gjérat të gatshme, kështu Evropa themi se po na shikon ndryshe, jo Evropa na shikon ashtu si jemi.

z. Adnan Reka: Transparent International eshtë i Evropës dhe kjo ka thënë për 17 vende Kosova ka lëvizur me lartë, ti po i mohon e herë po i pohon. Agim ti duhesh me iu gjëzuar shtetit që po funksionon.

Kryesuesi i Kuvendit: Shteti eshtë shtet dhe dallon prej pushtetit Adnan, nuk po dua me i relativizuar çështjet. Kushdo që eshtë në pushtet, nuk duhet me iu gjëzuar të keqes. Shteti ka funksionuar nga 2008 me ne e pa ne. E ke shumë gabim që thua se jemi duke funksionuar më mirë. Pushteti nuk guxon me ndikuar në zyrën e auditorit. Në vazhdim kryesuesi i përmendi vizitën 2 javore të kryeministrit Kurti në SHBA, në të cilën vizitë nuk u prit nga askush dhe ajo vizitë nuk sjelli ndonjë rezultat vendit.

znj. Arditra Rahmani: Si po shihet po devijon debati nga tema. Nuk e di se eshtë e drejtë kjo, nuk debatohet për pikën, atëherë ose vazhdojmë për pikën që eshtë temë debati ose e shtyjmë për mbledhjen vijuese.

z. Naim Beça: Unë nuk po e kuptoj a jemi anëtar të KK apo jemi deputet të Kuvendit të Kosovës. Agimit ia bëjë me dije se nuk mundet me na mësuar nevë të LVV se çka me debatuar. Ne nuk kemi punë me debatuar për viza se ajo nuk eshtë në kompetenca tona, ne debatojmë për çështje të komunës e jo për çështje të nivelit qendror. Tjetër, mos të hymë në çështjet e vizitave të kryeministrit që po thuhet e ka pritur apo se ka pritur kush kryeministrin. Nuk e di kush e ka prittë kryeministrin, i mirë apo i keq eshtë ky kryeministër që e ka dashtë populli. Ne nuk jemi kompetent me debatuar për çështje që i takojnë nivelit qendror. Unë jam këtu me folur këtu për çështje të komunës së Kaçanikut, për atë me ka zgjedhur populli.

z. Agim Çaka: Qëllimi ishte i mirë, normal se ne partitë politike bëjmë luftë për pushtet, shfrytëzimi i ndikimit nuk eshtë keq, për me sjellë punë të mira këtu. Në atë aspekt edhe unë

fola. Unë kur kam pasur ndikim në nivel qendror, kam punuar në të mirë të komunës, pavarësisht a kam qenë në pushtet apo jo. Tani e kemi deputetin nga komuna jonë i cili mundet me ndikuar atje, ai është deputet i jonë, pavarësisht nga subjekti politik, e ka në përgjegjësi me u marrë me punët e komunës tonë.

Kryesuesi i Kuvendit: Plani nuk votohet, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës e, **Diskutoj Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve në reportin e auditimit të dhënë nga ZKA, për vitin 2021/ Lënda: 01Nr. 470/03-16851/22.**

12. Plani i Reagimit Emergjent për mbrojtje nga fatkeqësitet natyrore dhe fatkeqësitet tjera në objektin e administratës komunale të komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, ia kaloj fjalën:

z. Ramadush Osmani: Plani i reagimit emergjent në objektin e komunës rrjedh pas miratimit të rregullores për mbrojtje nga zjarri dhe është një plan i detajuar teknik për masat që do të mirën që paraqiten në rast të ndonjë rreziku ose fatkeqësie qoftë natyrore apo objektive e subjektive. Është hartuar nga ZME në krye me Bujarin, ekspert i fushës, janë detajuar të gjitha hapat, përgjegjësitë dhe komponentët që ndodhën dhe duhet të mirën në rast të ndonjë fatkeqësie në objektin e komunës. Arsyja e këtij plani se, komuna është institucion publik me shumë të punësuar me hyrje dhe dalje dhe mund të paraqitet në çdo kohë rrezikshmëri e stafit dhe vizitorëve. Sesi duhet organizohet edhe stafi është i caktuar me plan, qoftë me kate apo mekanizëm përcjellës, qoftë me komponentë të cilat vijnë pas paraqitjes se një aksidenti të mundshëm. Arsyja është jo vetëm nga shkaqet natyrore, por edhe arsyesh mëri tjera objektive eksplodimeve, shkrepjeve me armë, apo të tjera që mund të vijnë. Këtu është kryesuesi i grupit që ka hartuar këtë plan, që mund të diskutoj për detaje tjera teknike.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Çaka: Materialin nuk e kemi pranuar. Objekti i komunës a ka shkallë emergjente? Unë mendoj se është obliguese objekti i komunës me pasur shkallët emergjente, këtë duhet futur në plan.

Kryesuesi i Kuvendit: Kur nuk iu vjen ndonjë pikë, është mirë me iu drejtuar zyrës së KK.

z. Ramadush Osmani: Çështja e shkallëve emergjente është ngritur edhe në KPF. Plani është i përgjithshëm, mund të ketë aksident, fatkeqësi që nuk lidhen fare me shkallë emergjente. Plani trajton edhe konfliktin fizik në mes të asamblistëve. Një prej faktorëve që duhet pasur një objekt me kate, janë shkallet emergjente, por ky plan parashev edhe vërsimet e tërmëtet, fatkeqësitë nga kërcënimet. Pajtohem me atë se një pjesë teknike e planit realizohet në objektin e komunës.

z. Besnik Salihu: A parashihet me këtë plan me pasur ashensor për të hendikepuarit? E di së është parakusht që objektet me pasur ashensor, me pasur kryje personat hendikep.

z. Ramadush Osmani: Në rast të ndodhjes se fatkeqësisë, plani e parashev rolin e secilit udhëheqës. Në aspektin teknik, ne po flasim për objektin e komunës që gjendja e tij dihet. Ashensori parashihet në kuadër të funksionimit të administratës lokale. Aktualisht nuk ka ashensor, por është përfituar si projekt dhe do të instalohet. Ai është pjesë e qasjes së personave me aftësi të kufizuara. Ky plan e përcakton rolin përgjegjës të secilit zyrtar nëse ndodhë aksidenti, sepse është në pyetje shëndeti i njeriut. Ne e mbajmë mend rastin e Restelicës, ka ndodhë një rrëshqitje e borës, ka pasur të vdekje, por ai aksion shquhet për shpëtimin e një vajze. Shpresoj të mos ndodhin aksidente, por nëse ndodhë, shpëtimi i një jete është sukses.

z. Ardit Rrahmani: Duke iu referuar grafikës që na e keni paraqitur, katër 1,2 dhe 3 janë 14 punëtorë, pjesa ku nuk është e mbuluar me kamera. A është paraparë që i gjithë objekti i komunës me qenë nën vëzhgim të kamerave?

z. Ramadush Osmani: Normalisht se po, shenjëz-imët kanë një kosto që do të lidhet me buxhetin e ndarë. Administrata komunale që është përgjegjëse për objektin parashevë buxhet për vendosjen e she-njëzimit në pajtim me këtë plani, ashtu si i kërkon grupi punues por edhe për siguri është çështja e revidimit të kamerave, duhet të bëhet një plan për rivendosjen e kamerave.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Pjesëmarrës në votim 24. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit i Reagimit Emergjent për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në objektin e administratës komunale të komunës së Kaçanikut/ Lënda: 01Nr.104/02-16957/22.

12. Propozim vendim për transfer dhe rialokim te mjeteve sipas buxhetit 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Për shkak të keq planifikimit të buxhetit, po vjen puna me transferuar mjete buxhetore.

z. Bahri Selimi: Nuk ka keq planifikim të buxhetit të komunës, por çështja është që gjatë vitit ligji i buxhetit, ligji për financat publike dhe përgjegjësitë, ligji për vetëqeverisje lokale, i parashohin ndryshimet buxhetore, bile e parashevë rishikimin e buxhetit. Secila qeveri kur nuk i ka parashikuar saktë buxhetin, bëhet rishikimi i buxhetit, por kur nuk ka rishikim, lejohen transferet edhe në shuma me të mëdha, mos me lejuar na kthehen prapa. Për mos me prapësuar një donacion që na ka ardhur të sektori i bujqësisë, ne nuk i kemi pasur krejt mjetet se subvencionet janë të kufizuara, në vitin e kaluar i kemi pasur 300.000€, sivjet i kemi vetëm 55 mijë euro të bujqësia, tani DBPZHR sivjet e ka realizuar një projekt, pajisje për bujqësi, ka ardhur projekti, mjetet janë shpenzuar, ndërkaq qysh me kthyer prapë donacionin. Nuk jemi duke shtuar apo rritur buxhetin, por kur ka ardhur donacioni, ne duhet me ekzekutuar si ekzekutiv, me përfituar qytetari. Na tani vendosim se ku mundemi me kursyer mjete të MSH, duke lënë ndonjë aktivitet, janë marrë të zyra e kryetarit, zyra e personeli, zyra e KK, se lejohen 15% e ndarjeve buxhetore me u transfeuar në ndonjë program tjetër, kur kemi mjete mangut, duke lënë anësh ndonjë aktivitet të mallrat dhe shërbimet, që drejtoritë që merren me punë administrative.

z. Agim Mani: Të Zyra e kryetarit, fillimisht janë transferuar 5000 € të planifikuara, dhe nuk janë realizuar, kjo është keq-planifikim.

Kryetari i Komunës: Me është dukur me e arsyeshme me i transferuar në projektin e bujqësisë, se janë do mjete që kanë ende kohë kur shpenzohen.

z. Bahri Selimi: Kryetari i komunës sigurisht ato mjete do t'i shpenzonte për sigurim të karburanteve, furnizim zyre me material shpenzues, apo vjetari që bëhet në fund të vitit. Bëhet fjalë për 210 sera që përfitojnë qytetarët.

z. Betim Shala: Të rialokimi i mjeteve që janë hequr mjetet nga ndërtimi i trotuarit në f. Stagovë, a kanë qenë 50.000 € të ndara, 42.000 € është kontrata. Nga gjendja e terrenit që kam parë është e pamundur me u realizuar projektin me këto mjete, për shkak së një pjesë e murit duhet me qenë 1m e gjysmë.

z. Ramadush Osmani: Unë ia kam propozuar drejtorit, si njësi kërkuese me alokuar në një projekt tjetër të 2 projektet. Për trotuarin në Stagovë i kemi me buxhet 50.000 €, dhe kontrata është 42.000 €. Unë kam kërkuar me i hequr 5.000 € nga ky projekt, se ka mundësi 10% me mjete të mbetur me realizuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjtë u aprovua me 15 votë Për, 7 Kundër, Abstenim 1. Pjesëmarrës në votim 24. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për transfer dhe rialokim te mjeteve sipas buxhetit 2022/ Lënda: 01Nr. 400/01-16994/22.

13. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Bob, parcela me nr. 175-0, në emër të Bekim (Emrush) Dema - harmonizimi i vendimit sipas kërkesës së MAPL;

Kryesuesi i Kuvendit: Këtë vendim e kemi marrë në mbledhjen e kaluar, MAPL ka kërkuar me harmonizuar dhe i njëjtë është harmonizuar sipas kërkesës së MAPL. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me 14 votë Për, Kundër nuk ka Abstenim 10. Pjesëmarrës në votim 24. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Bob, parcela me nr. 175-0, në emër të Bekim (Emrush) Dema - harmonizimi i vendimit sipas kërkesës së MAPL/ Lënda: 01Nr. 60/01-15020.

14. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Begracë, 17 parcela të evidentuara në emër të N.P.P.T.T.SH. ALK-OIL me nr. të biznesit 70052105 dhe Drilon Shamollit - harmonizimi i vendimit sipas kërkesës së MAPL;

Kryesuesi i Kuvendit: Këtë vendim e kemi marrë në mbledhjen e kaluar, MAPL ka kërkuar me harmonizuar dhe i njëjtë është harmonizuar sipas kërkesës së MAPL. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me 15 votë Për, Kundër nuk ka, Abstenim 9. Pjesëmarrës në votim 24. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Begracë, 17 parcela të evidentuara në emër të N.P.P.T.T.SH. ALK-OIL me nr. të biznesit 70052105 dhe Drilon Shamollit - harmonizimi i vendimit sipas kërkesës së MAPL/ Lënda: 01Nr. 60/01-15021/22.

15. Kërkesa e MBPZH për Anulimin e Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 01402-1 ZK Soponicë, me kulturë Bujqësore Arë e Klasës së 5, me sipërfaqen 3917m², pronë e Ekrem (Ramadan) Hyseni nga Ferizaj, nën qiramarje 99 vjet;

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesa e MAPL është për anulim të vendimit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Ne kur është marrë ky vendim kemi qenë kundër, ndërkaq sot do të votojmë Për.

z. Agim Çaka: Ne këto vendime që i kemi miratuar në mbledhjen e kaluar i kemi votuar me shumicë votash, tani çka kemi punë ne me këto vendime.

Kryetari i Komunës: Ministria ka kërkuar me i anuluar këto vendime.

Kryesuesi i Kuvendit: Arsyetimet i keni në material në shkresën e ministrisë. Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim këtë pikë dhe i njëjtë u aprovua me 19 votë Për, Kundër 1, Abstenim 3. Pjesëmarrës në votim 24. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Kérkesës së MBPZHR për Anulimin e Vendimit të KK 01Nr. 06-350/02-7606/22 të datës 29.04.2022 -për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 01402-1 ZK Soponicë, me kulturë Bujqësore Arë e Klasës së 5, me sipërfaqen 3917m², pronë e Ekrem (Ramadan) Hyseni nga Ferizaj, nën qiramarrje 99 vjet / Lënda: 01Nr.350/02-16991/22.

16. Kérkesa e MBPZHR për Anulimin e Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 01123-6 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Nuk u paraqit kush, atëherë kérkesën e MBPZHR e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 20 votë Për, Kundër 1, Abstenim 3. Pjesëmarrës në votim 24. Në saje të kësaj del konstatimi së KK mori:

VENDIM

Për Aprovimin e Kérkesës së MBPZHR për Anulimin e Vendimit të KK 01Nr. 06-350/01-2433/22 të datës 29.04.2022 -për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 01123-6 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI / Lënda: 01Nr.350/02-16992/22.

17. Kérkesa e MBPZHR për Anulimin e Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 00311-0 zona kadastrale Ivajë, me kulturë bujqësore Livadh i klasës së 6, pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Të interesuar nuk ka për diskutim, atëherë kérkesën e MBPZHR e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 18 votë Për, Kundër 1, Abstenim 5. Pjesëmarrës në votim 24. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë: Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori:

VENDIM

Për Aprovimin e Kérkesës së MBPZHR për Anulimin e Vendimit të KK 01Nr.06-350/02-6286/22 të datës 31.05.2022 -për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 00311-0 zona kadastrale Ivajë, me kulturë bujqësore Livadh i klasës së 6, pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku.

Kryesuesi i Kuvendit: Theksoj se në muajin korrik do t'i shqyrtojmë mundësitet me i mbajtur 2 mbledhje, ndërkaq muaji gusht është muaj i pushimit. Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, mbledhja i përfundoj punimet në ora 15:07. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 24 anëtarë, me arsyë ikën me herët nga mbledhja, Raif Kasa gjatë shqyrtimit të pikës 4, Hamide Luma gjatë shqyrtimit të pikës 9.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

SMalsiu



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);**

Nga Mbledhja e VI (gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2022, mbajtur me 27.06.2022:

1. Kemal Murseli,
2. Brahim Imishti.....,.....,
3. Hamide Luma,.....,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Fitore Vishi,.....,.....,
6. Rrustem Zenuni,.....,.....,
7. Edon Baftiu,.....,
8. Selajdin Troni,.....,
9. Fatmir Bunjaku,.....,
10. Bashkim Krasniqi,.....,
11. Florina Lika-Vishi,.....,
12. Lejla Muhamheri-Çaka.....,.....,
13. Agim Mani,.....,
14. Kadrije Lika-Troni,.....,
15. Adnan Reka,.....,
16. Naim Beça,.....,
17. Raif Kasa,.....,
18. Ernesta Krasniqi,.....,.....,
19. Bashkim Luma,.....,
20. Arta Avdiu,.....,
21. Ardita Rrahmani,.....,
22. Besnik Salihu,.....,
23. Betim Shala,.....,.....,
24. Arlinda Rakoci-Raka.....,.....,
25. Rabije Sallahi.....,.....,
26. Ekrem Livoreka.....,.....,
27. Agim Çaka.....,.....,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

08.07.2022

01-060/01-14063



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Kaçanik, 08.07.2022.

Për: Anëtarët e Kuvendit/ znj. Kadrie Troni

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtuar para Kuvendit të Komunës, më datë, 27.06.2022

Znj. Kadrie Troni

A ekziston rregullorja per kutien e ankesave dhe a ka afat a jo, sepse më duket qe i ka dalë afati këtë vitë?

E nderuar, ju njoftojmë që ekziston një rregullore për hapjen e kutive të ankesave në komunen tone me NR.02/2016, dhe kjo rregullore ka vlefshmeri deri ne plotesim ndryshim te saj ose te hartimit te rregullores se re e cila do te shfuqizonte aktualen .

Gjithashtu ekziston edhe kutia e ankesave e cila gjendet e vendosur ne katin e përdhesë të objektit të komunes.

Po ashtu ekziston edhe komisioni per hapjen e këtyre kutive të ankesave i cili ka validitet deri me datë 28.09.2022.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,

